



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
NDERMARRJA E PRODHIMIT TE ÇELIQEVE
ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Data 20.03.2015

Shtojca 15

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: *[Santi sh.p.k.]*

Procedura e prokurimit: Ruajtja dhe sigurimi i objekteve të Ndërmarrjes së Prodhimit të Çeliqueve Elbasan me roje private

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[6781116.5 (gjashte milion e shtateqind e tetedhete e nje mije e njeqind e gjashtembedhete presje pese leke) pa TVSH me afat deri ne 31.12.2015]*

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike *[16.02.2015]* *[Numri 6]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- | | |
|---|--------------------------------------|
| 1. Kumria 1 sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | K32712210C
<i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera 6731880 leke (gjashte milion e shtateqind e tridhete e nje mije e teteqind e tetedhete leke) pa TVSH
<i>(me numra dhe fjalë)</i> | |
| 2. Santi sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | K32710209L
<i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera 6727471.5 leke (gjashte milion e shtateqind e njezete e shtate mije e katerqind e shtatedhete e nje mije presje pese leke) pa TVSH
<i>(me numra dhe fjalë)</i> | |
| 3. Myrto Security sh.p.k.
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | K23323401N
<i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera 6739759 leke (gjashte milion e shtateqind e tridhete e nente mije e shtateqind e pesedhete e nente leke) pa TVSH
<i>(me numra dhe fjalë)</i> | |
| 4. Eurogjici Security shpk
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | K31929010K
<i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera 6691503.63 leke (gjashte milion e gjashteqind e nentedhete e nje mije e peseqind e tre presje gjashtedhete e tre leke) pa TVSH
<i>(me numra dhe fjalë)</i> | |

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- | | |
|---|--------------------------------------|
| 1. Eurogjici Security shpk
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | K31929010K
<i>numri i NIPT-it</i> |
| Vlera 6691503.63 leke (gjashte milion e gjashteqind e nentedhete e nje mije e peseqind e tre presje gjashtedhete e tre leke) pa TVSH
<i>(me numra dhe fjalë)</i> | |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Eurogjici Security shpk me Nipt K31929010K

Ne oferten e paraqitur nga operatori ekonomik Eurogjici ky operator ka nderhyre ne preventivin e miratuar nga autoriteti kontraktor duke ndryshuar sasine ne zerin percate 10 muaj e duke e ndryshuar ate ne 9.94 si me poshte:

Nr.	Zerat e shpenzimeve	Vlera leke
1	Paga mujore per nje punonjes sherbimi	33,000
2	Shtesa page per veshtersi sherbimi Turni II + III-te neni 81 Kodi Punes	5,329.65
4	Shuma (1+2+3)	38,329.65
5	Sigurime shoqerore dhe shendetesore 16.7%	6,401.05
	Shuma	44,730.7
6	Shpenzime nderlidhjeje	0.00003
7	Shpenzime armatimi/licenca/certifikatat e punonjesve	148.61
10	Shuma ne muaj per nje punonjes	44,879.3
	Shuma per 15 punonjes ne nje muaj	673,189.5
	Shuma per 15 punonjes per 9.94 muaj pa tvsh	6,691,503.63
11	Vendosja e nje sistemi kamerash monitoruese (4 cope + kabell+DVR)	0.00099
	Shuma pa TVSH	6,691,503.63

Persa me lart ky operator ka vepruar ne kundershtim me DT dhe legjislacionin perkates dhe per kete rast oferta e tij refuzohet si e papranueshme mbeshtetur ne argumentimin e meposhtem:

DT:

Seksioni 1. Hartimi i ofertës

1.1 Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme.

LPP

Neni 53

Shqyrtimi i ofertave

3. Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

VKM Nr. 914, datë 29.12.2014

Neni 14

Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët

1. Udhëzimet duhet të përmbajnë të gjithë informacionin e duhur për përgatitjen e ofertës, si dhe veprimet që ndalohen me ligj. Në to shpjegohet se pjesëmarrësit në procedurën e prokurimit duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të tenderit, pa bërë asnjë ndryshim.

Ne rastin konkret operatori Eurogjici ka ndryshuar pjesen e zerave te shpenzimeve e cila eshte caktuar nga autoriteti kontraktor ne masen e 10 muajve. Keshtu oferta e paraqitur nga ky operator nuk eshte sipas kerkesave te DT dhe per kete arsye refuzohet.

Nese ofertuesi ne paraqitjen e ofertes se tij kishte pretendime apo paqartesi ai mund te orientohej sipas nenit 42 te LPP

Neni 42

Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit

1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit⁹³

Shqyrtimi i dokumentacionit ligjor kualifikues.

Ne nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."

Ak-ja ne shtojcen 7, pika 2/b dhe c kriteret e vecanta te kualifikimit,

Ka kerkuar:

- Subjektet e SHPSF-së duhet të paraqesin, çertifikaten per titullar subjekti dhe licencën e shoqërisë me **nënkategorinë I.3 A “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”**. Janë të vlefshme edhe licencat aktive, të dhëna në zbatim të ligjit nr. 75/2014 ”Per sherbimin privat te sigurise fizike”
- Subjektet e SHPSF-së duhet të paraqesin licencën ose certifikatën e drejtuesit teknik me **nënkategorinë I.3 A “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private si dhe veprimtarive social kulturore, sportive fetare e politike”**. Janë të vlefshme edhe licencat aktive, të dhëna në zbatim të ligjit nr. 75/2014 ”Per sherbimin privat te sigurise fizike”.

Ne ligjit 75/2014 “Per SHPSF”, Neni 7, kategorite e Licenes,

nenkategoria 1.3.A, “Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive,fetare e politike, i cili ushtrohet ne te gjithë territorin e vendit.

nenkategoria 1.3.B, “Sigurimi dhe shoqerimi i vlerave monetare e sendeve te çmuara gjate transportit”, i cili ushtrohet ne te gjithë territorin e vendit.

Ak-ja ne shtojcen 7, pika 2/i ne kerkesat e vecanta per kualifikim, thekson:

Operatori ekonomik te keqe ne funksionim Qender Kontrolli (Salle Operative) me grup te gatshme per perballimin e situatave emergjence si dhe paisje per sistem radiokomunikimi dhe alarmi, e paisur me radionderlidhje, qe do te nevojiten per mbarevajtjen e sigurimit te godinave te NPC-se Elbasan. Salla Operative me grup te gatshem dhe funksionimi i saj te vertetohet me vertetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Elbasan per vitin 2015.

- A. ShRSF “Eurogjici” shpk, ne vertetimin nga DPQ-te Elbasan me nr.441 prot. Dt.27.01.2015, vertetohet se ka 17 punonjese me list emrore, por nuk ka Qender Kontrolli (salle operative), me grup te gatshem ne **kategorine e licences nenkategoria 1.3.A,** “*Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private i personave si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive,fetare e politike, i cili ushtrohet ne te gjithë territorin e vendit.* Pra kriteri kualifikues i percaktuar ne dokumentat e tenderit nuk eshte permbushur nga shoqeria juaj.

Ak-ja ne shtojcen 7, pika 2/f ne kerkesat e vecanta per kualifikim,

Thekson:

V vertetim nga administrata tatimore, per numrin e punonjesve te siguruar per periudhen: Janar- dhjetor 2013 dhe Janar - Dhjetor 2014, si dhe muajin Janar 2015 per jo me pak se 15 (pesembedhjetë) punonjese sherbimi, te shoqeruar me listepagesat (E-SIG 025) te vertetuara nga organet tatimore.Ku te pasqyrohen pagat,shtesat mbi page, sigurimet shoqerore e shendetesore si dhe TAP-i te vertetuara nga organet tatimore.

- B. Nga verifikimi i listepagesave E-SIG 025 te Shoqerise Euro-gjici shpk, nuk rezultone asnje punonjese sherbimi i çertifikuar nga DPQ Elbasan sipas listes emrore te kesaj te fundit, **me 17 punonjese** te jene paguar me shtesat mbi page, duke mos paguar detyrimet ndaj shtetit per sigurimet shoqerore, shendetesore ne masen 16.7% per shtesat mbi page. Ky kriteri kualifikues i percaktuar ne dokumentat e tenderit nuk eshte permbushur nga kjo shoqeri.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Santi sh.p.k. me adrese Elbasan se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 6727471.5 leke (gjashtë milion e shtatëqind e njetë e shtatë mijë e katerqind e shtatëdhjetë e një mijë presje pese leke) pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *NPC Elbasan, zryra e finances* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 6731880 leke (gjashtë milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e teteqind e tetëdhjetë leke) pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 02.03.2015

Ankesa: Po

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë 09.03.2015.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
DREJTORI**

Besnik GAXHO